



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

### **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

të mbledhjes së katërt të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,  
mbajtur më 02.06.2022, e cila filloi në orën 13:30.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, dhe anëtarët e Komitetit: Ramadan Salihu, Gyltene Retkoceri dhe Ermira Shabani.

Munguan: Mehreme Llumnica, Jeton Canhasi dhe Armend Ademi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli-Mustafa, me këtë

#### **REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara;
2. Të arriturat e takimeve me drejtoritë e përcaktuara nga anëtarët e Komitetit;
3. Mbajtja e turnirit në shah për PAK për Ditën e Çlirimit të Prishtinës;
4. Të ndryshme.

**Pika e parë**

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të KKPAK-së.

Kryesuesja konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të KKPAK-së.

**Pika e dytë**

Të arriturat e takimeve me drejtoritë e përcaktuara nga anëtarët e Komitetit.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese** dha sqarime, duke thënë se më 16 maj kanë pasur takime me Drejtorinë e Arsimit. Në këtë takim ka marrë pjesë Ramadani dhe Ermira, ku kemi diskutuar lidhur me zbatimin e Plani të veprimit për PAK dhe cilat pika i ka me prioritet DKA-ja, po ashtu për ekipin vlerësues, për transportin e fëmijëve, në këtë rast edhe fëmijëve në kopshte dhe shkolla, pastaj kemi diskutuar për infrastrukturën brenda shkollave, të gjitha ato pika që janë në PV.

DKA është zotuar se do t'i përmbahet PV-së me mundësitë që kanë, mirëpo janë disa çështje që nuk varen nga DKA-ja, por varen nga niveli qendror dhe niveli qendror nëse ndan buxhet për të punësuar asistente edhe mësimdhënës mbështetës, atëherë DKA-ja mundet me i bërë, pikë kyçe në fokus kanë qenë pagesa e transportit për fëmijët e institucioneve parashkollore, DKA-ja nuk e ka një vendim të tillë, një vendim të tillë e kanë vetëm për nxënësit. Janë zotuar se me miratimin e buxhetit për këtë vit do ta kenë si prioritet pagesën e transportin edhe për fëmijët që ndodhen në IP, theks të veçantë i kemi kushtuar Ekipit vlerësues komunal për vlerësimin e fëmijëve, ku për shkak të fluksit të madh të regjistrimit të fëmijëve dhe të kërkesave të shumta të institucioneve, ky ekip e ka të pamundur me një afat të shkurt kohor me i përfunduar këto kërkesa të institucioneve, për shkak se ky ekip punon në të njëjtin kohë në një institucion dhe në të njëjtën kohë e kryen edhe një punë tjetër ku i vlerëson fëmijët, mirëpo me prioritet e kanë marrë të paktën këta 3-4 muajt e fundit, nëse munden me përafruar numrin e kërkesave që ishte di kund mbi 80.

**Ramadan Salihu** bëri të ditur se DKA-ja u ka dhënë rëndësi fëmijëve me aftësi të kufizuara, sepse kanë caktuar një zyrtare për këtë kategori. Pra kjo tregon se megjithatë trajtohet çështja e aftësisë së kufizuar në nivel permanent sa u përket fëmijëve.

Dy kërkesat tona të themi si suplementare ndaj PV-së, që ky komision, grupi vlerësues, të shndërrohet në grup permanente vlerësues, për shkak se kemi në komunitet fëmijë që kanë vonesa në vlerësim dhe prindërit pastaj bien në dilema të mëdha se kah t'i orientojnë fëmijët e tyre, në qendra burimore apo në shkolla të rregullta, dhe për aftësi të mbetura të tyre fizike apo shqisore të sillet institucioni, kërkesa tjetër ishte se ka raste që në çerdhe i dërgojnë fëmijët edhe prindërit me aftësi të kufizuara. Ka raste kur njëri prind është me aftësi të kufizuara, por ka raste edhe kur të dy prindërit janë me aftësi të kufizuara, prandaj sipas pikëpamjes tonë nuk mjafton vetëm kur është fjala për fëmijët me aftësi të kufizime të lirohen nga pagesat, por edhe kur i kanë prindërit ma aftësi të kufizuara, sepse është rasti shumë më social se ndoshta kur është vetëm fëmija me aftësi të kufizuara. Përgjigjja e tyre ishte korrekte, sepse gjithçka nuk është e parapamë në buxhetin e Komunës, ata vetëm mund t'i mirëkuptojmë, por jo të nisin diçka konkretisht të punojnë në atë drejtim.

Sa u përket burimeve njerëzore dhe Drejtorisë së Administratës, edhe këtu kemi pasur interesim të theksuam të shkojmë, pikërisht kolegja Mehreme e pati përmend një mundësi që 20 PAK do të punësohen në Komunën e Prishtinës, përveç aspekteve monitoruese që i kemi si përshkrim i punës, dëshironim shtesë informata për këtë numrin prej 20 PAK për punësim, se a është e vërtetë, apo vetëm fjalë goje që qarkullon në komunitet? Unë propozoj që të mos mbetet pas pushimeve, sepse është shumë me rëndësi të insistohet

edhe më tepër te këta edhe te nënkryetari i Komunës, që po ashtu ka qenë edhe ai këtu, ka qenë premtues se do të bëhet diçka lidhur PAK.

**Gyltene Retkoceri** informoi se ia kanë dërguar një kërkesë Drejtorisë së Shëndetësisë, që me pasur takim në datën e caktuar, mirëpo nuk i është kthyer përgjigje nja 10 ditë, pastaj e kemi përsëritur kërkesën prapë dhe e ka caktuar një takim për sot, por e ka anuluar sot në mëngjes.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese**, dha sqarime se drejtori e ka anuluar takimin për shkak se Asociacioni i Komunave i ka ftuar në takim urgjent sot, andaj ai ka kërkuar takim nesër për në orën 10:30. Ka kërkuar me konfirmuar duke pasur parasysh që mosgaditshmërinë e anëtarëve për t'u takuar kohëve të fundit. Unë nesër nuk jam në Prishtinë dhe unë nuk e mora atë përgjegjësi me thënë takohemi, duke e ditur që nuk do të shkojë asnjë prej anëtarëve, edhe pse zotëri Ramadan u paraqit, andaj unë i kam thënë pas datës 12-13 qershor ju kontaktojmë dhe e caktojmë një takim.

Po për drejtorinë e tjera çka ka, Gyltene?

**Gyltene Retkoceri** tha se ka pasur me u takuar me drejtorinë e Mirëqenies Sociale, mirëpo në takimin e kaluar u dakorduar mos me shkuar, se veç informatat i kemi, jemi takuar me drejtoreshën këtu, që u raportua çka është punuar komplet.

Duke pasur parasysh që Armendi nuk është ardhur sa mbledhje dhe në asnjë drejtori nuk ka kryer asnjë takim, a kishte qenë e mundur që ne në shtator me i ftuar këta drejtorë e me mbajte një mbledhje me të gjithë?

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese**, tha se në shtator do ta thërras një mbledhje, ku do ta zgjedhim një kryesi të re të Komitetit, dhe do të shohim në ndërkohë me Premtimen si janë Udhëzimet administrative për komitet, se të merret përgjegjësi nga një person dhe të tjerët të mos angazhohen, për mua nuk është në rregull, kështu që tutje procedurat kemi me i pa brenda anëtarëve, me qenë kaç të pa ndërgjegjshëm anëtarët e komitetit mua nuk më ka rastisur, me qenë vetë PAK dhe mos me lobuar për të drejtat e veta, nuk më ka rastisur. Unë nuk e mbaj emrin kryesuese përderisa nuk ka efekt Komiteti, unë tërhiqem prej emrit kryesuese përderisa nuk i kom anëtarët aktivë, andaj në shtator unë duhet ta zgjedh çështjen e statusit tim, të jem kryesuese apo jo.

#### **Pika e tretë**

#### **Mbajtja e turnirit në shah për PAK për Ditën e Çlirimit të Prishtinës.**

**Ramadan Salihu** tha se edhe në seancën e kaluar e kemi cekur se do të mbahet turneu, ne si Komitet mendojmë që ky të jetë turne tradicional që të mbahet çdo vit. Mbetet të shihet më tutje, kjo është pjesë e projektit të vitit të kaluar, siç e kom cekur, për shkak se Federata e Shahut na ka ndihmuar, na e ka siguruar sallën, kronometrat dhe referin, kështu që këto lehtësirat na kanë kursyer në buxhetin që na ka lejuar drejtorja. Ne këtë vite nuk aplikua për shkak se kanë mbetur mjete nga viti i kaluar dhe me këto mjete do ta organizojmë turnirin. Sot e mora konfirmimin për lehtësirat e njëjta nga sekretari i Federatës së Shahut

të Kosovës, tha se jeni të mirëseardhur të premtën, në orën 10:15, ndoshta ndonjë anëtarë i Komitetit vjen.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese,** tha se do të jetë jashtë vendit e nuk mundet të marrë pjesë, për këtë event, për këtë hapje. Uroj që ndonjë prej anëtarëve të Komitetit të jetë pjesë e këtij turniri, juve ju përgëzoj për transparencën dhe organizimin e këtij eventi.

**Ramadan Salihu** tha se arsyeja pse unë insistoja me ardhur të paktën nëse ju dërgoj unë ftesë tash OJQ-ve, shoqatave, si individë t'u dërgoj në emër të Komitetit pasi që miratohet propozimi.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese,** pyeti se a janë të pajtimit anëtarët me miratuar propozimin e zotëri Ramadanit, me u dërguar e-mail OJQ-ve, që më 10 qershor 2022, në orën 10:00 fillon hapja e këtij eventi.

**Ermira Shabani** u shpreh e pajtimit me propozimin.

*Mbledhja përfundoi në orën 15:00.*

Procesmbajtësja:  
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit  
Fatime Demolli - Mustafa

